



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:005560  
Datë: 21.11.2024  
Numri i dokumentit: 06488412

Ac.nr.8767/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ylber Shurdhiqi, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore O. Q., kundër të paditurit Xh. R. nga fshati Ll., Komuna e Gj., lidhur me çështjen juridike rimbursim dëmi, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.74/2020, të datës 07.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit Xh. R. nga fshati Ll., Komuna e Gj., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.74/2020, i datës 07.10.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.74/2020, të datës 07.10.2022, ka vendosur si në vijim: I. MIRATOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Xh. R. nga fshati Lla., Komuna e Gj. dhe DETYROHET i padituri që paditëses t'ia rimbursoj shumën prej 3,731.00 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 19.05.2018 në Gjilan, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke u llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit. II. Obligohet i padituri që paditëses t'ia paguaj shpenzimet gjyqësore në shumë prej 40.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet ankesa e të paditurit dhe të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në

shkallën e parë, ose aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe të refuzohet padia e paditëses si e pa bazuar.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me padinë e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensoj shumën prej 3,731.00 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 19.05.2018 në Gjilan, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe t'i paguaj edhe shpenzimet gjyqësore të cilat do t'i caktoj gjykata, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, të cekura në pjesën arsyetuese të aktgjyimit të atakuar, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.74/2020, të datës 07.10.2022, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat që ka administruar ka vendosur si në dispozitiv vendimit të saj, nga arsyet se nuk ka qenë kontestues fakti se ky aksident kishte ndodhur atëherë kur njësia "A" të cilën e drejtonte vozitësi i automjetit Kamion-Cisternë i markës "Mercedez", me tabela të regjistrimit ..., me pronar D. Z., ndërsa, ngasës i këtij automjeti kishte qenë Xh.R., tani i padituri i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk kishte pasur mbulesë siguroese dhe automjeteve të njësisë "B", "C" dhe "D", të cilët ishin duke lëvizur në rrugën nacionale Gjilan-Bujanovc, me të kaluar Fabrikën e Bllokave në Crep, NJ"B" të cilin e drejtonte B. N. me automjetin për transport "MAN" me tabela të regjistrimit ..., i cili ishte ndalë në shiritin e djathtë të rrugës, pasi që NJ-....( të cilën e drejtonte A.D. me automjetin "Golf" të markës "VË") ishte ndalë për të ndërruar gomën me defekt dhe me këtë, NJ-A e cila ishte duke lëvizur pas NJ-"B", nuk arrin të ndalet ku edhe kalon në shiritin e majtë të rrugës dhe me anën e djathtë të pjesë së përparme e godet në anën e majtë të pjesë së pasme NJ-B e nga forca goditëse NJ "B" me anën e djathtë të pjesës së përparme e godet në anën e majtë të pjesës së pasme NJ "C", ndërsa me cepin e majtë të mbrojtësit të përparëm, NJ "A" e godet në anën e majtë edhe NJ"D" ( të cilën e drejtonte I. K., me automjetin "Golf" me tabela të regjistrimit 6...) i cili ishte duke lëvizur nga ana e kundërt. Si pasojë për veq dëmeve materiale, lëndime trupore kanë pësuar Sh. D., I. K., A.D., N. M. dhe "Elkos" NPT. Paditësja në cilësinë e siguresit kishte kompensuar dëmin dhe të dëmtuarve iu ka paguar shpërblimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 3,731.00 €.

Tutje ka theksuar se nga Shkresa e transferit bankar të BPB në emër të Sh. D. e datës 09.07.2018, Ujdia jashtë gjyqësore e lidhur më 11.06.2018 në mes të BKS-A. D., Vendimi i datës 06.06.2018 mbi konstatimin e dëmit të lëshuar nga Departamenti i Dëmeve në BKS për Sh. D., Vendimi i Komisionit të Shkallës së parë për Trajtimin e Dëmeve i datës 06.06.2018, Komisioni i brendshëm për vlerësimin e dëmit, i datës 04.06.2018 me nr. të dosjes ..., si dhe pesë fotografit nga vendi i ngjarjes, gjykata vërtetoi faktin se nga Fondi i Kompensimit të BKS-së për të autorizuarin e të dëmtuarës Sh. D., A.D. është ndarë shuma prej 1,170.00€, ku edhe të njëjtit me BKS-në kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore ku janë pajtuar që në emër të dëmit material në automjet të dëmtuarës t'i paguhet shuma e lartcekur në emër të zhdëmtimit pasiqë edhe Komisioni i Shkallës së parë e ka miratuar vendimin për kompensimin e dëmit material për automjetin e dëmtuar me rastin e aksidentit ashtu siç shihet edhe në fotografitë nga vendi i ngjarjes.

Nga Transferi bankar nga Banka Ekonomike për I. K. i dt.12.07.2018, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 29.06.2018 e lidhur në mes të BKS dhe av. B. I. për I.K., Vendimi i datës 22.06.2018 i BKS, Vendimi i BKS për I. K. për dëmet e shkaktuara, Vendimi i Komisionit të Shkallës së Parë për trajtimin e dëmit dosja nr. ... i dt.13.06.2018, Shkresa e Komisionit të Brendshëm për Vlerësimin e Dëmeve të lëshuara nga BKS nr. i dosjes .... dt.11.06.2018, Vendimi i datës 13.06.2018 për I. K. për dëmet e lëshuar nga BKS, 5 foto të automjetit të dëmtuar, gjykata vërtetoi faktin se shuma e propozuar nga Komisioni i Komisionit të Brendshëm për vlerësimin e dëmit ka qenë 701€, shumë kjo e cila është aprovuar edhe nga Komisioni i Shkallës së Parë për vlerësimin e Dëmeve, kjo shumë është transferuar të autorizuarit të dëmtuarit dhe të njëjtit me BKS-në kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material- në automjet për shumën e lartcekur si dhe nga fotot shihen dëmtimet në automjet.

Nga shkresa nr.685/18, Transferi bankar për N. M. e dt.25.07.2018, Ujdia jashtëgjyqësore e dt.19.07.2018 e lidhur në mes të BKS dhe N. M., Vendimi nr. i dt.11.07.2018 për N.M., Vendimi i Komisionit për trajtimin e dëmit dosja nr.... e dt.11.07.2018, Shkresa e komisionit të brendshëm për vlerësimin e dëmeve në emër të N. M. e datës 10.07.2018, Shkresa e vlerësimit të dëmeve për N. M. e dt. 19.05.2018, Vlerësimi mjekësor për N. M. e datës 27.06.2018, Shkresa e Spitalit Regjional në Gjilan e dt.29.05.2018 në emër të N. M., Raporti nga konsulta mjekësore për N. M. e dt 23.05.2018 në pesë fletë, Raporti i ekokariografisë për N. M. i dt.04.06.2018, Raporti i Spitalit të Emergjencës në Gjilan i dt.19.05.2018 në emër të N. M. në gjashtë fleta, gjykata vërtetoi faktin se i dëmtuari në këtë aksident në bazë të raporteve mjekësore ka pasur lëndime të lehta trupore dhe i autorizuari i të dëmtuarit ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me BKS për kompensimin e dëmit jomaterial ku nga Fondi i Kompensimit të BKS-së i janë ndarë mjetet në shumë prej 479€ në emër të dëmit material dhe jomaterial ku edhe Komisioni i Vlerësimit të Dëmit dhe Komisioni i Brendshëm ka caktuar këtë shumë.

Për bazë ligjore i është referuar nenit 18 paragrafi 1 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku parashihet se *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësies, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*.

Po ashtu, gjykata vlerëson se e drejta për regres paditëses, i takon edhe në bazë të paragrafit 3 të të njëjtit nen “*Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.*”, ku në këtë procedurë kontestimore, me prova u vërtetua fakti se paditësja e kishte përmbushur detyrimin ndaj palëve të treta, të cilës i padituri iu kishte shkaktuar dëm material dhe jo material.

Po ashtu, baza e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit, gjendet në nenin 136.1 të Ligjit Për Marrëdhëniet E Detyrimeve (tani e tutje referuar me shkurtesën LMD), sipas të cilit “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Neni 137 i LMD përcakton “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”. Ndërsa, baza për shpërblimin e dëmit personit të tretë nga paditësja, mbështetet në nenin 918 të LMD-ës “*Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër*”. Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore e ka bazuar në nenin 452 të LPK-së, (më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditëses, e parashtruar kundër të paditurit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin, përkatësisht aktgjykimi është hartuar në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Për sa i përket pretendimit ankimor për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, që i referohen aprovimit të kërkesëpadisë, për shkak se nuk është vërtetuar baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e

shkallës së parë bazën juridike të kërkesëpadisë e ka vërtetuar përmes raportit të aksidentit nr. .... i dt.19.05.2018, ku sipas këtij raporti është vërtetuar se me datë 19.05.2018, me veprimet e të paditurit ka ardhur deri te aksidenti në komunikacion me dëme materiale dhe jo materiale në atë mënyrë që rreth orës 16:25, kishte ndodhur aksident trafiku, në të cilën kanë qenë të përfshirë disa automjete, ky aksident kishte ndodhur atëherë kur njësia “A” të cilën e drejtonte vozitësi i automjetit Kamion-Cisternë i markës “Mercedez”, me tabela të regjistrimit ...., me pronar D. Z., ndërsa, ngasës i këtij automjeti kishte qenë Xh. R., tani i padituri i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk kishte pasur mbulesë siguruese dhe automjeteve të njësisë “B”, “C” dhe “D”, të cilët ishin duke lëvizur në rrugën nacionale Gjilan-Bujanovc, me të kaluar Fabrikën e Bllokave në Crep, NJ“B” të cilin e drejtonte B. N. me automjetin për transport “MAN” me tabela të regjistrimit 03..., i cili ishte ndalë në shiritin e djathtë të rrugës, pasi që NJ-C (të cilën e drejtonte A. D. me automjetin “Golf” të markës “VË”) ishte ndalë për të ndërruar gomën me defekt dhe me këtë, NJ-A e cila ishte duke lëvizur pas NJ-“B”, nuk arrin të ndalet ku edhe kalon në shiritin e majtë të rrugës dhe me anën e djathtë të pjesë së përparme e godet në anën e majtë të pjesë së pasme NJ-B e nga forca goditëse NJ “B” me anën e djathtë të pjesës së përparme e godet në anën e majtë të pjesës së pasme NJ “C”, ndërsa me cepin e majtë të mbrojtësit të përparëm, NJ “A” e godet në anën e majtë edhe NJ“D” ( të cilën e drejtonte I.K., me automjetin “Golf” me tabela të regjistrimit 6....) i cili ishte duke lëvizur nga ana e kundërt. Si pasojë për veq dëmeve materiale, lëndime trupore kanë pësuar Sh. D., I. K., A. D., N.M. dhe “Elkos” NPT. Lartësinë e dëmit e ka vërtetuar nga ujdite jashtë gjyqësore të datave 11.06.2018, 29.06.2018, 19.07.2018, 24.07.2018 dhe 17.09.2018, si dhe nga urdhër transferet bankare të datave 09.07.2018, 12.07.2018, 25.07.2018, 02.08.2018 dhe 24.09.2018, në bazë të të cilit është vërtetuar se pala paditëse e ka paguar shumën e kërkuar sikur se në padi palëve të dëmtuara.

Mbi bazën e të lartcekurave, meqenëse me qëllim të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit, me datë 19.05.2018, paditësja dhe i dëmtuari Sh.D., më datë 11.06.2018 kanë lidhur ujdë jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 1170.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 19.05.2018, në Gjilan, paditësja dhe i dëmtuari I. K., më datë 29.06.2018 kanë lidhur ujdë jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 701.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 19.05.2018, në Gjilan, paditësja dhe i dëmtuari N. M., më datë 19.07.2018 kanë lidhur ujdë jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 479.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 19.05.2018, në Gjilan, paditësja dhe i dëmtuari A. D., më datë 24.07.2018 kanë lidhur ujdë jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 660.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 19.05.2018, në Gjilan, dhe paditësja dhe i dëmtuari KS “Sigma”, për ELKOS NTP, më datë 17.09.2018 kanë lidhur ujdë jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit, në shumën e përgjithshme prej 721.00 euro, që i dëmtuari ka pësuar nga aksidenti i trafikut më datë 19.05.2018, në Gjilan, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare të datave 09.07.2018, 12.07.2018, 25.07.2018, 02.08.2018 dhe 24.09.2018, së bashku me listën e pagesave, në emër të kompensimit të dëmit sipas afatit të paraparë me ujdë gjyqësore për çka me nenin 18 para. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia parashihet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të*

*drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”. Ndërsa parag.4 i nenin 18 të këtij ligji shprehimisht thotë: “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.*

Duke u bazuar në të lartcekurat, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses, për Gjykatën e Apelit rezultoi si i drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

Lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat nga neni 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar edhe pretendimin tjetër ankimor lidhur me nxjerrjen e provës për vlerësimin e dëmeve, për të cilin me anë të ankesës ka pretenduar se nuk ka pasur provë, mirëpo Gjykata e Apelit, vlerëson se ky pretendim me anë të ankesës vlerësohet si i pa bazuar, për arsye se propozimi për nxjerrjen e provave ishte dashur që të propozohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht një propozim i tillë nuk mund të paraqitet me ankese, ngase me nenin 180 par.1 të LPK-së përcaktohet: *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*. Andaj, pala e paditur edhe nëpërmes ankesës nuk ka arritur të provoj me asnjë provë se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë propozimin për nxjerrjen e provës për vlerësimin e dëmeve.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.8767/2022 me dt.18.11.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari,  
Ylber Shurdhiqi